

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ALTA GROUP SHPK Beograd, me seli në adresën Ugrinovacka 212, lokali nr. 1, Zemun-Beograd, Serbi, përmes Martin Ivanovit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 19.06.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ALTA GROUP SHPK Beograd, me seli në adresën Ugrinovacka 212, lokali nr. 1, Zemun-Beograd, Serbi, do të fitojë kontroll mbi STOPANSKA BANKA SHA Manastir me seli në adresën Dobrivoje Radosavljeviq nr. 21, Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e dukshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Obligohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 23.05.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ALTA GROUP SHPK Beograd, me seli në adresën Ugrinovacka 212, lokali nr. 1, Zemun-Beograd, Serbi, me të cilën ALTA GROUP SHPK Beograd do të fitojë kontroll mbi STOPANSKA BANKA SHA Manastir me seli në adresën Dobrivoje Radosavljeviq nr. 21, Manastir, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcave të tij konstatoi sa vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ALTA GROUP SHPK Beograd është kompani e specializuar për shërbime në qarkullimin pagesor, e cila kryen aktivitete afariste në tregun në Serbi me rrjetin më të madh të pikave të

pagesës. Ajo është shoqëri mëmë që bashkon, ndër të tjera, edhe shoqëritë e lidhura ALTA BANKA SHA Beograd dhe PROCOOPAC SHPK Beograd, shoqëri me seli në Beograd dhe e regjistruar për ndërtimin e ndërtesave banesore dhe jo-banesore.

Veprimtaritë themelore të ALTA BANKA SHA Beograd janë kryerja e qarkullimit pagesor në vend dhe jashtë vendit, punët kreditore, punët e depozitave dhe shitblerja e devizave. Aktivitetet e tjera përfshijnë lëshimin e garancive, hapjen e akreditivave dhe shërbime të tjera bankare, ndërsa përmes shoqërisë së lidhur ALTA LEASING SHPK Beograd, ALTA BANKA SHA Beograd i zgjeron aktivitetet e saj edhe në fushën e lizingut.

ALTA GROUP SHPK Beograd dhe shoqëritë e tij të lidhura nuk janë të pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

STOPANSKA BANKA SHA Manastir është një nga bankat komerciale rajonale në tregun maqedonas me histori të gjatë të aktivitetit afarist dhe prani të fuqishme në fushën e shërbimeve financiare, duke përfshirë mbledhjen e depozitave, miratimin e kredive, qarkullimin pagesor, bankingun elektronik dhe aktivitete të tjera shoqëruese bankare.

STOPANSKA BANKA SHA MANASTIR i ka personat e lidhur vijues të cilët janë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

1. ODA EKONOMIKE AMERIKANE NË MAQEDONINË E VERIUT Bashkësi Interesash Ekonomike, me seli të subjektit në Maksim Gorki nr. 11, Shkup dhe me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera në bazë të anëtarësimit, të papërmendura diku tjetër;
2. Shoqata për realizimin e interesave të përbashkëta të bankave dhe avancimin e punës së tyre ASOCIACIONI BANKAR MAQEDONAS Shkup, me seli të subjektit në Orce Nikollov nr. 75, Shkup dhe me veprimtari prioritare – veprimtari të organizatave të tjera në bazë të anëtarësimit, të papërmendura diku tjetër.;
3. Shoqëria për tregti dhe shërbime PELAGONIJA FAJNANS SHPK Shkup – në likuidim, me seli të subjektit në Maqedonia nr. 38, Shkup dhe me veprimtari prioritare veprimtari menaxhuese.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ